



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1020 Prot.

Tiranë, më 17 / 07 / 2020

V E N D I M

Nr. 71, Datë 17 / 07 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.65, datë 02.07.2020, të paraqitur nga M. K, kundër: Kompanisë “Sanitary Cleaning” sh.p.k dhe Kompanisë “Univers Service” sh.p.k, në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues parashtron se është diskriminuar nga Kompania “Sanitary Cleaning” sh.p.k pasi është larguar pa të drejtë nga puna. Ankuesja citon se ka qenë e punësuar pranë këtij subjekti në pozicionin e “Përgjegjëses së Turnit” në Shërbimin e Lavanderisë, pranë SRD, që nga data 25.05.2018 deri në muajin Qershor 2020. Ajo pretendon se është trajtuar në mënyrë të diferencuar nga ana e punëdhënësit në lidhje me punonjëset e tjera duke e përjashtuar nga lista e punonjësve për të përfituar pagën e luftës. Znj.K citon se: *“Nëpërmjet një mesazhi (sms) menaxherja e Kompanisë më ka njoftuar përfundimin e marrëdhënies së punës me datë 16 Qershor 2020 duke më llogaritur ditë pune edhe pushimet vjetore. Gjatë viteve të mia të punës pranë kësaj Kompanie më është mohuar e drejta për të shfrytëzuar pushimet vjetore dhe as më është dhënë pagesë për pushimet vjetore të pakryera. Nuk më janë paguar raportet mjekësore dhe nuk jam paguar për punën jashtë orarit. Nuk ka*

¹ Pa përcaktuar një cilësi apo shkak.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

patur me mua një kontratë pune të formalizuar në letër por më është dërguar nëpërmjet emailit një kopje e kontratës së punës ku mungon firma ime. Nuk janë të cituara kushtet e kontratës që mbajnë të lidhur punonjësën kur punëdhënësi transferon ndërmarrjen. Kjo Kompani nuk më ka njoftuar që asaj i ka përfunduar kontrata pranë Spitalit Rajonal Durrës (SRD) dhe që tashmë i ka kaluar Kompanisë “Univers Service” sh.p.k.

Kompania “Univers Service” sh.p.k me fillimin e punës së saj pranë SRD u tregua korrekte me mua duke më nënshkruar kontratën e punës në pozicionin e mëparshëm (Përgjegjëse Turni) me të njëjtin nivel page, mirëpo gjatë mbledhjes që bëri Kompania për prezantimin e stafit, mua më komunikuan që nuk mund të vazhdoja punën si gjithë koleget e tjera duke më thënë tekstualisht: “Je e padëshiruar nga Grupi i Monitorimit të SRD”. Kompania “Univers Service” sh.p.k. pasi shprehu gatishmërinë dhe vullnetin për të më marrë fizikisht në punë duke e reflektuar këtë dhe në kontratën që kemi nënshkruar së bashku, më mohon të zënit me punë në pozicionin që unë mbaj. Përveç se dua të zihem me punë, përgjegjësia ime ligjore në kushtet e ndonjë ngjarjeje të jashtëzakonshme do të jetë evidente. Edhe pse unë nuk jam fizikisht aty, figuroj punonjëse e atij Subjekti në Shërbimin e Lavanderisë në pozicionin e “Përgjegjëses së Turnit”. “.

Subjekti ankues vijon duke cituar se ajo është trajtuar në mënyrë jo të barabartë duke e penguar të vazhdojë punën lirisht, pa patur asnjë arsye të justifikuar ligjorisht për këtë situatë , duke i shkatëruar asaj dëm shëndetësor/fizik dhe moral.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga KMD:

- Të konstatojë diskriminimin e saj nga punëdhënësi.
- Të rikthehet në vendin e punës duke i mundësuar ushtrimin e së drejtës për punësim pa u penguar nga palët e treta.
- Të detyrojë Kompaninë “Sanitary Cleaning” sh.p.k ta dëmshpërblejë për dëmin fizik e moral të shkaktuar nëpërmjet veprimeve e mosveprimeve të saj.
- Të detyrojë Kompaninë “Univers Service” sh.p.k ta zërë me punë në të njëjtin pozicion pune të dakortësuar me të nëpërmjet kontratës së punës dhe me të njëjtin nivel page”.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye,nëpërmjet e-mail-it të datës 29.06.2020, Specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave, pranë Zyrës së KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nëpërmjet shërbimit postar, me datë 24.06.2020 subjekti ankues ka dërguar dokumentacionin plotësues³, por sërish nuk ka shpjeguar dhe dokumentuar shkakun për të cilin ka pretenduar diskriminimin. Tek Rubrika “Shkaku për të cilin pretendohet diskriminimi” i Formularit të Ankesës është shënuar “çdo shkak tjetër”, pa asnjë shpjegim, argumentim apo dokumentacion lidhur me çfarë referon tek ky shkak subjekti ankues.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë

³ Protokolluar pranë KMD me shkresën me nr.837 prot., datë 25.06.2020, si dhe dërguar nëpërmjet e-mailit personal: merita_cela@yahoo.com, me datë 02.07.2020.

dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikoj se cili është ky shkak.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të ligjit 10 221/2010, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvehte është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, subjekti ankues nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në LMD.

Subjekti ankues lidhur me pretendimin e diskriminimit “për çdo shkak tjetër”, shprehet ndër të tjera se, se arsyeja është se ajo nuk ka pranuar të bëhet pjesë e paligjshmërisë së veprimeve të Kompanisë⁴ pranë së cilës ka punuar dhe ka respektuar ligjin. Sa më sipër, Komisioneri, nuk e gjen të bazuar në ligj si një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Përkundrazi, respektimi i ligjit është detyrim ligjor i çdo punonjësi, në zbatim të detyrave funksionale të tij dhe si i tillë nuk përbën shkak për diskriminim.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁴ Duke mos provuar as me dokumentacion dhe as me prova e fakte të tjera këto deklaramë.

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues M. K, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Çdo shkak tjetër